



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË  
PËRGJITHSHËM SHKODËR

**UDHËZIM I PËRGJITHSHËM**

**NR. 30 , DATË 21.11.2023**

**PËR**

**“MBI RITJEN E EFIÇENSËS NË BASHKËPUNIMIN ME PROKURORINË E  
POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR”.**

Në mbështetje të neneve 148 e vijues të “Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, si dhe në neneve 41, 42, 43, 46, 47, 48, 50 e vijues të Ligjit Nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale, të Urdhërit të Drejtuesit të Prokurorisë me Nr.02, datë 07.01.2021, “Për Miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër” e ndryshuar, si dhe shkresës së Prokurorit të Përgjithshëm me nr.1737, datë 15.11.2023, “Mbi rritjen e efiçensës në bashkërendimin me Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”;

**UDHËZ O J :**

1. Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të njihen dhe të zbatojnë detyrimet ligjore në lidhje me bashkërendimin dhe bashkëpunimin me Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, sipas përcaktimeve të Aktit të Koordinimit Ndërinstitucional
2. Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, nxiten të rrisin efiçensën në bashkërendimin institucional ndërmjet kësaj Prokurorie dhe Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, duke rritur bashkëpunimin dhe rastet e shkëmbimit të informacionit dhe të akteve në zbatim të parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale si dhe në kuadër të zbatimit të Aktit të Koordinimit Ndërinstitucional, datë 15.12.2020 “Për rritjen e efiçencës dhe unifikimin e disa veprimtarive administrative dhe procedurale ndërinstitucionale duke respektuar veçoritë dhe kompetencat institucionale të parashikuara me ligj.
3. Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, nxiten të zbatojnë me kujdes të shtuar, dispozitat procedurale lidhur me kompetencën lëndore, në funksion të rritjes së efektivitetit të drejtësisë penale.

4. Prokurorët udhëzohen të bëjnë një kalim sa më të shpejtë të akteve dhe/ose tërheqjen e akteve duke shmangur zvarritjen e afateve procedurale dhe duke garantuar procesin e rregullt ligjor, duke kryer në kohë veprimet e duhura dhe të shpejta procedurale dhe administruar në kohë provat që mund të dëmtohen si rrjedhojë e kohës dhe procedurës së shpalljes së moskompetencë dhe kalimin e akteve në Prokurorinë e Posaçme.
5. Prokurorët udhëzohen, që në kryerjen e veprimeve hetimore e procedurale të shpejta të mbajnë parasysh sigurimin e efektivitetit dhe vazhdimësisë së hetimeve proaktive në rastet kur gjatë hetimit evidentohen subjekte ose vepra penale për të cilat kjo prokurori nuk ka kompetencën lëndore dhe vendosin menjëherë dërgimin e akteve Prokurorisë së Posaçme.
6. Në të gjitha rastet kur ka dyshime për mungesë kompetencë, prokurori i çështjes informon menjëherë Drejtuesin e Prokurorisë, me qëllim nxjerrjen e udhëzimit jo të detyrueshëm ose për marrjen e masave të kordinimit të veprimeve me Prokurorinë e Posaçme dhe kalimin e dosjes dhe akteve sa më shpejt në prokurorinë kompetente.
7. Drejtuesi i Prokurorisë në bashkëpunim me Drejtuesit e Seksioneve do të marrin masat e duhura dhe do të koordinojnë në mënyrë sa më efektive këtë veprimtari përmes kontakteve dhe komunikimeve të vazhdueshme me përfaqësuesit e Prokurorisë së Posaçme, sipas përcaktimeve të Aktit të Koordinimit Ndërinstitucional, për të shmangur çdo vonesë apo zvarritje që mund të dëmtojë ecurinë e hetimit.
8. Me këtë urdhër dhe për zbatimin e tij, të njihen të gjithë Prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe zyra e regjistrat.
9. Moszbatimi i këtij urdhëri pasjell përgjegjësi ligjore apo disiplinore sipas rastit.
10. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

## **DREJTUESI I PROKURORISË**

**ALBERT MURÇAJ**

